

VENDIM
Nr.565, datë 14.7.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.210, DATË 28.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LEJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT TË KALIMIT TË PRONËSISË PËR TROJET E
OBJEKTEVE TË PRIVATIZUARA NGA SHOQËRITË HUAMARRËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.210, datë 28.4.1999 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi “... Agjencia Kombëtare e Privatizimit ...” të zëvendësohet me “... Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave ...”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “... Grupi mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse ...” të shtohen “... dhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha